



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 147

Tiranë – E premte, 7 gusht 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11580, datë 5.8.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 9401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 17.7.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë) 9401
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 17.7.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë) 9402
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 119, datë 17.7.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAS” sh.a., për zgjatjen e procedurës administrative, për shqyrtimin e kërkesës për licencim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror..... 9403
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 120, datë 17.7.2020	Mbi zgjatjen e procedurës administrative, për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror..... 9404
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 121, datë 17.7.2020	Mbi licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike lundrues mbi rezervuarin e Hec Banja, me kapacitet të instaluar 2 mw.. 9406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 122, datë 17.7.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., për pezullimin e procedurës administrative, për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë..... 9407
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 613, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020, ‘Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 145, datë 6 gusht 2020..... 9409

**DEKRET****Nr. 11580, datë 5.8.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Sabri Hazir Fejzullahu
2. Nerxhivane Islam Fejzullahu (Krasniqi)
3. Ermal Sabri Fejzullahu
4. Ariana Fazli Fejzullahu (Cakiqi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 117, datë 17.7.2020****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR
(SHITJE ME PAKICË)**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 50; 22, pika 2, germa “c” dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “ç”; 5; 6; 8; 9 pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “p” dhe nenin 12, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr.

83/1 prot., datë 2.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 6, datë 10.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë GSA sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 41 prot., datë 14.1.2020 dhe atë me nr. 41/1, datë 11.2.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit të konstatuar të munguar.

- Në përgjigje të shkresave të ERE-s, me *e-mailin* e datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.

- Në lidhje me këtë kërkesë të shoqërisë, Bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 69, datë 22.4.2020, me anë të të cilit ka zgjidhur me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, për një afat 10-vjeçar, deri më 12.7.2020. Shoqëria është njoftuar për këtë vendim nga ERE me shkresën nr. 651 prot., datë 22.4.2020.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.41/2 prot., datë 19.6.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezultoi i plotësuar tërësisht, si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar tërësisht.



- Neni 9, pika 2, “i”, “ii”, “iii”:

i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion Nm³, e parashikuar për t’u livruar gjatë një viti. Plotësuar.

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE një deklaratë në të cilën shprehet se planifikon të operojë në fushën e furnizimit të gazit natyror duke përdorur rrjetin e transmetimit TAP Ag, si dhe atë ekzistues (të ri, publik apo privat), në Shqipëri, për furnizimin e klientëve fundorë potencialë, rrjedhimisht do të furnizojë gaz natyror me standardet e cilësisë që TAP Ag mundëson, si dhe në përmbushje të të gjitha kriterëve të cilësisë që përcaktohen në rregulloret e aplikueshme në Shqipëri. Shoqëria deklaron se për shkak se ndodhet në hapat e para të licencimit, nuk disponon ende një marrëveshje me TAP Ag, por sapo të nënshkruhet një e tillë do ta paraqesë në ERE.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Shoqëria “GSA” sh.p.k. të depozitojë në ERE garancinë e cilësisë së gazit, para fillimit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 118, datë 17.7.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR (SHITJE ME SHUMICË)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 50; 22, pika 2, germa “ç” dhe nenit 83, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “ç”; 5; 6; 8; 9 pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “e” dhe nenin 12, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 83/2 prot., datë 2.7.2020 për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 5, datë 10.1.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 41 prot., datë 14.1.2020, ERE ka përcjellë pranë shoqërisë njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësim të dokumentacionit

- Me *e-mailin* e datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.

- Lidhur me këtë kërkesë të shoqërisë, Bordi i ERE-s është shprehur me vendimin nr. 70, datë 22.4.2020, duke zgjatuar me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes finale për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, për një afat 10-vjeçar, deri më 12.7.2020.

- Shoqëria është njoftuar për këtë vendim nga ERE, me shkresën nr. 651 prot., datë 22.4.2020.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 41/2 prot., datë



19.6.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GSA” sh.p.k., në bazë të nenit 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, rezulton i plotësuar, si më poshtë vijon:

- Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar.

- Neni 9, pika 2, “i”, “ii”, “iii”:

i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm³, e parashikuar për t’u livruar gjatë një viti. Plotësuar.

ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të sistemit. Plotësuar pjesërisht. Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka përcjellë në ERE një deklaratë në të cilën shprehet se planifikon të operojë në fushën e tregtimit të gazit natyror duke përdorur rrjetin e transmetimit TAP Ag dhe rrjedhimisht do të tregtojë gaz natyror me standardet e cilësisë që TAP Ag mundëson, si dhe në përmbushje të të gjitha kriterëve të cilësisë që përcaktohen në rregulloret e aplikueshme në Shqipëri. Shoqëria deklaron se për shkak se ndodhet në hapat e para të licencimit, nuk disponon ende një marrëveshje me TAP Ag, por sapo të nënshkruhet një e tillë do ta paraqesë në ERE.

iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej licencës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit. Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë), për një afat 10-vjeçar.

2. Shoqëria “GSA” sh.p.k. të depozitojë në ERE garancinë e cilësisë së gazit para fillimit të ushtrimit të aktivitetit.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 119, datë 17.7.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ALBGAS” SHA, PËR ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E OPERIMIT TË HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/1 prot., datë 8.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. “Për shtyrjen e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 25.11.2019, filloi procedurën për licencimin e



shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 32/55 prot., datë 25.11.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 729/1 prot., datë 3.12.2019, ka përcjellë pranë subjektit “Albgaz” sh.a. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të konstatuar.

- Me shkresat nr. 84 prot., datë 16.1.2019 dhe nr. 288/1 prot., datë 4.2.2020, ERE i është drejtuar shoqërisë me një kujtesë për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 288/2 prot., datë 8.2.2020, ka përcjellë në ERE kërkesën për shtyrje të vendimmarrjes së Bordit, në pamundësi për t’i plotësuar këto dokumente brenda afateve dhe ka deklaruar se një pjesë e tyre është në proces përpilimi.

- Bordit i ERE-s, me vendimin nr. 43, datë 6.3.2020, vendosi të pranojë kërkesën e shoqërisë për shtyrjen e vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë, deri në datën 1.7.2020.

- Së fundmi (përpara përfundimit të këtij afati), shoqëria Albgaz sh.a., me shkresën nr. 122/1 prot., datë 29.6.2020, protokolluar në ERE me nr. 288/4, datë 29.6.2020, ka paraqitur sërish në ERE kërkesë për shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit mbi këtë licencim deri në datën 10.10.2020, duke argumentuar se për shkak të mbylljes së çdo shërbimi që erdhi si rezultat i pandemisë COVID - 19, nuk ka pasur mundësi të plotësojë dokumentacionin e munguar dhe kërkon miratimin e ERE-s për të shtyrë këtë vendimmarrje.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të vendimit të Bordit, është depozituar përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, datë 6.3.2020 dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, kërkesa e shoqërisë është e arsyeshme dhe e bazuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencimin

në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.

2. Shoqëria Albgaz sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar, jo më vonë se data 1.10.2020.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 120, datë 17.7.2020

MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 16, pika 12; neneve 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/3 prot., datë 13.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 13, datë 23.1.2020, filloi procedurën për licencimin e



shoqërisë “Albpetrol” sh.a. , në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 62/2 prot., datë 24.1.2020, ka kryer njoftimin në median e shkruar. Me shkresën nr. 291 prot., datë 28.1.2020, ka përcjellë pranë shoqërisë “Albpetrol” sh.a. njoftimin për vendimin e fillimit të procedurës dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në lidhje me dokumentacionin e munguar, të konstatuar në dosjen e aplikimit dhe nevojën për informacion shtesë.

- Në seancën e caktuar në datën 7.2.2020, nuk u paraqit asnjë nga përfaqësuesit e “Albpetrol” sh.a. , ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 291/1 prot., datë 12.2.2020, duke i rikujtuar kërkesën për plotësim dokumentacioni apo dhënien e informacionit shtesë në lidhje me aplikimin e “Albpetrol” sh.a.

- Në vijim, me shkresën protokolluar në ERE nr. 291/2 prot., datë 2.3.2020, shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar në aplikimin për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), për shkak se shoqëria është në proces ristrukturimi dhe nga ky ristrukturim janë prekur punonjës të cilët e kishin për detyrë të merreshin me plotësimin e këtij dokumentacioni. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. thekson se e ka të domosdoshme pajisjen me këtë licencë, duke qenë se në objektin e veprimtarisë së saj ka kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 291/5 prot., datë 1.7.2020, me anë të së cilës i ka kërkuar marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të depozituar brenda datës 6.7.2020, të gjithë dokumentacionin e munguar, në plotësim të kërkesave të sipërcituara të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. me shkresën nr. 3799 prot., datë 6.7.2020, protokolluar në ERE me nr. 291/6, datë 6.7.2020, ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit mbi këtë licencim.

- Për shkak të situatës së krijuar nga COVID - 19, vendimit nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” dhe masave që u morën në vijim të udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për

parandalimin e përhapjes së COVID-19, shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka punuar me staf të reduktuar, orar të reduktuar dhe nga shtëpia. Kjo situatë ka çuar në vështirësi në lidhje me koordinimin dhe përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar nga ERE në kuadër të licencimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Shoqëria “Albpetrol” sh.a. kërkon nga ERE shtyrjen me 3–6 muaj të afatit për plotësimin e dokumentacionit të munguar, pasi shoqëria e ka të domosdoshme pajisjen me licencën e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë), duke qenë se në objektin e veprimtarisë së saj ka kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në përputhje me ligjin nr. 7746, datë 20.8.1993 “Për hidrokarburet”, të ndryshuar.

- Duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të vendimit të Bordit është depozituar në afat dhe duke marrë parasysh të gjitha kufizimet e vendosura gjatë kësaj periudhe me qëllim parandalimin e përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, ERE vlerëson se kërkesa e shoqërisë është e arsyeshme dhe e bazuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për zgjatjen e afatit të procedurës administrative, për shqyrtimin e kërkesës, për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, deri në datën 6.1.2021.

2. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. të marrë masa për të depozituar në ERE dokumentacionin e munguar jo më vonë se data 31.12.2020.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 121, datë 17.7.2020**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“STATKRAFT RENEWABLES ALBANIA”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK LUNDRUES MBI
REZERVUARIN E HEC BANJA, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa ‘a’, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/6 prot., datë 13.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC Banjë, me kapacitet të instaluar 2 mw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr.102, datë 24.6.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e Hec Banja, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. është një subjekt përfaqësues në cilësinë e mbajtësit të miratimit, i cili ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 6077 rep., nr. 1657 kol., datë 19.12.2019, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC Banjës, Bashkia Cërrik, me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me miratimin përfundimtar nr. 4657/2 prot., datë 31.05.2019, ka miratuar ndërtimin e centralit fotovoltaik lundrues dhe veprave të tij ndihmëse mbi rezervuarin e HEC Banjës, Bashkia Cërrik, qarku Elbasan, nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me kapacitet të instaluar 2 mw.

- Me shkresën nr. 62/17, datë 26.6.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” (data 9.7.2020), nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 754/1 prot., datë 26.6.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 753/2 prot., datë 7.7.2020, ka përcjellë dokumentacionin e konstatuar në mungesë.

- Shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton i plotësuar tërësisht:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.5, germa “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.



- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.4.4, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni leje nga institucione të tjera (neni 9, pika 4.4.5, germat: “a” dhe “b”, është plotësuar në mënyrë korrekte.

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

- Nga studimi i fizibilitetit të hartuar për centralin fotovoltaiik lundruer të shoqërisë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k. rezulton se jetëgjatësia e një paneli nuk shkon më tepër se 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Statkraft Renewables Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik lundruer mbi rezervuarin e HEC Banjë, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 122, datë 17.7.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, PËR PEZULLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE, PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 73/2020, MBI MIRATIMIN E “KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, DHE FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT UNIVERSAL/FSHU, PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 55 dhe 66, të Kodit të procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 15 dhe 16, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 86/5 prot. datë 13.7.2020, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, lidhur me kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë”,

konstatoi se:

- Në datë 22.4.2020, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 73, u shpreh në lidhje me miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të shërbimit universal/FSHU, për furnizimin e klientëve fundorë”.



- Në datën 7.5.2020, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 3882 prot., ka paraqitur kërkesën për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 93, datë 8.6.2020, vendosi: Zgjatjen me 30 ditë të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020, mbi miratimin e “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë” si të pa mbështetur në prova të reja të tilla që mund të çojnë Bordin e Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në rishikimin e tij.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE, me shkresën nr. 675/5 prot., datë 18.6.2020, iu drejtua shoqërisë FSHU sh.a. me kërkesën për informacion më të zgjeruar në lidhje me shkaqet ligjore që e çuan në një kërkesë të tillë për rishikimin e dispozitave të kontratës së miratuar, si dhe kërkesën për një analizë të argumentuar në lidhje me impaktin financiar që sipas FSHU sh.a. mund të shkaktojnë dispozitat e kontratës e cila është miratuar nga ERE pas një procesi të gjatë konsultimi me palët në kontratë, si dhe palët e interesit.

- Në vijim të kërkesës së ERE-s si më sipër, si dhe brenda afatit të parashikuar në vendimmarrjen e ERE-s nr. 93, datë 8.6.2020, për shtyrjen e afatit të trajtimit të kërkesës për rishikim të vendimit të ERE-s nr. 73, datë 22.4.2020, shoqëria FSHU sh.a., me shkresën e saj protokolluar në ERE me nr. 675/6, datë 6.7.2020, iu drejtua ERE-s me shpjegime në lidhje me sa kërkuar, si dhe kërkesën për zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së ERE-s në lidhje me kërkesën për rishikim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020.

- FSHU sh.a. argumenton se: FSHU sh.a. ka kërkuar rishikim të pjesshëm të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020, e më konkretisht ndryshime në nenin 9, pika 3, të kontratës së miratuar me vendimin e sipërcituar, duke sqaruar se parashikimi i kësaj dispozite rrit kostot e sigurimit të energjisë elektrike me bazë ditore/orare në treg të parregulluar. Blerja e emergjencës me bazë orare/ditore rrit riskun e sigurimit të kësaj energjie, si dhe çmimin e blerjes.

- FSHU sh.a., në shkresën e saj të datës 6.7.2020, mes të tjerave bën me dije se është në proces negociimi me shoqërinë KESH sh.a., palë në këtë kontratë, për të dakordësuar ndryshime në dispozitat e kontratës TIP, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73/2020.

- Në nenin 55 dhe 66, të “Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet dhe shqyrtohet nga organi publik kompetent. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballlet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë.

- Në analizë të sa më sipër, duke vlerësuar se hapat procedural të ndjekur nga FSHU sh.a., për të adresuar në ERE jo vetëm kërkesën për rishikim por edhe atë për pezullim e zënie të afatit për trajtimin e kërkesës pas plotësimit të kushtit (mbylljes së negociatave me KESH sh.a.), janë të ligjshëm e në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Vlerësojmë se kjo kërkesë duhet vlerësuar, e palëve në këtë kontratë u duhet dhënë koha e nevojshme për diskutim e negociim mbi ndryshimet e propozuara në dispozitën për të cilën është kërkuar rishikimi i vendimit të ERE-s nr. 73/2020.

- Në kuptim të parashikimeve të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, nenit 16 pika 3, është e rëndësishme të ritheksojmë se: Kërkesa për rishikim vendimi nuk pezullon zbatimin e vendimit me përjashtim kur Bordi vendos ndryshe.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 73, datë 22.4.2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal, për furnizimin e klientëve fundorë”, mbetet në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,



VENDOSI:

KORRIGJIM GABIMI

1. Pranimin e kërkesës së shoqërisë FSHU sh.a. për pezullimin e procedurës administrative për rishikimin e vendimit të ERE-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe furnizuesit të shërbimit universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”, deri në përfundimin e negociatave mes palëve në kontratë, për ndryshimet në nenin 9, të kësaj kontrate.

2. Shoqëria FSHU sh.a., të informojë ERE-n mbi ecurinë e negociatave për qëllime të rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73/2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/FSHU sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

Shtojca IV “Metodat e transferimit të të dhënave nga institucionet financiare të detyruara për të komunikuar me administratën tatimore në kuadër të shkëmbimit automatik të informacionit të llogarive financiare”, që duhej t’i ishte bashkëlidhur vendimit nr. 613, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020, Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 145, datë 6 gusht 2020, faqe 9229.



SHTOJCA IV

METODAT E TRANSFERIMIT TË TË DHËNAVE NGA INSTITUCIONET FINANCIARE TË DETYRUARA PËR TË KOMUNIKUAR ME ADMINISTRATËN TATIMORE NË KUADËR TË SHKËMBIMIT AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE

Institucionet financiare te cilat kerkohen te raportojnë, u kërkohet te komunikojne sipas parashikimeve në këtë dispozitë.

Administrata Tatimore vërteton paraqitjen e komunikimeve të përmendura me anë të një certificate në të cilën, pas përpunimit të kontrollit, tregohen:

- a) në rast të një rezultati pozitiv:
 - i. identifikuesi i *skedarit* i atribuar nga subjekti që bën komunikimin;
 - ii. protokoli i caktuar ne menyre automatike në *skedar*;
 - iii. data ne te cilen *skedari* eshte derguar
- b) në rast të një rezultati negativ, për shkak të pamjaftueshmërisë së rregullave të transmetimit, anomalive në nomenklaturën e *skedarit*, parregullsive në strukturën e të dhënave ose mospërputhjet midis të dhënave të komunikuara:
 - i. identifikimi i *skedarit* i atribuar nga subjekti që bën komunikimin;
 - ii. protokoli i caktuar ne menyre automatike në skedar;
 - iii. data ne te cilen skedari eshte derguar
 - iv. arsyeja e refuzimit

Në rast të një rezultati negativ e cila sjell refuzimin, komunikimi do konsiderohet se nuk është paraqitur.

Perpunimi i te dhenave

Informacioni i përmendur në këtë dispozitë i transmetohet Administrates Tatimore në përputhje me legjislacionin për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbledhet në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të tatimpaguesve.

Administrata Tatimore përpunon të dhënat e komunikuara dhe i transmeton ato tek autoritetet kompetente të juridiksioneve që i nënshtrohen komunikimit, sipas metodave dhe kushteve të përcaktuara nga direktiva ose nga marrëveshjet përkatëse dhe marrëveshjet teknike të lidhura.



METODAT E TRANSFERIMIT TE TE DHENAVE NGA INSTITUCIONET FINANCIARE TE DETYRUAR PER TE KOMUNIKUAR ME ADMINISTRATEN TATIMORE NE KUADER TE SHKEMBIMIT AUTOMATIK TE INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE

RREGULLAT E KOMUNIKIMIT

1.1 OBJEKTI I DOKUMENTIT

Ky dokument përshkruan rregullat e përpilimit dhe transmetimit nga Institucionet Financiare Shqiptare të kërkuara për të komunikuar drejt Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve informacionin në lidhje me shkëmbimin e detyrueshëm automatik të informacionit në sektorin fiskal.

1.2 TERMINOLOGIA

Akronim	Kuptimi
AEOI	Automatic Exchange of Information
ASCII	American Standard Code for Information Interchange
CRS	Common Reporting Standard Standard i Përbashkët i Raportimit
FATCA	Foreign Account Tax Compliance Act
IBAN	International Bank Account Number
IF	Institucione Financiare shqiptare te detyruara per te komunikuar
IN	Identification Number –perdoret ne vend te TIN, ne rastin e nje personi juridik
ISO	International Organization for Standardization
MB	Megabyte
MS	Member State
N/A	Not Applicable
OBAN	Other Bank Account Number



Akronim	Kuptimi
OECD	Organisation for Economic Cooperation and Development
TIN	Tax Identification Number – Numri i identifikimit fiskal
XML	Extensible Mark-up Language
XSD	XML Schema Definition
OICR	Organismo di Investimento Collettivo del Risparmio Skema e Investimeve Kolektive
SGR	Società di gestione del risparmio Kompania e administrimit të kursimeve

Shënim teknik në lidhje me terminologjinë: formati i miratuar për komunikimin e të dhënave të raportimit financiar është formati XML i CRS-se. Kjo rregullon organizimin dhe llojin e informacionit që përmbahet në skedarët XML, të cilat validojnë zyrtarisht çdo skedar XML, pra ka një strukturë specifike dhe informacioni është i organizuar në bazë të llojeve të të dhënave nga më të thjeshtë deri me të ndërlikuarat, të kombinuara me njëra-tjetrën në të ashtuquajturat blloqe informacioni. Disa blloqe të veçanta janë nga ana tjetër gjithashtu të korigjueshme dhe karakterizohen nga një specifike, i cili përcakton metodat e korigjimit. Në këtë kontekst, **Dokumenti**, përcaktohet si blloku minimal i informacionit të korigjueshem dhe specifikimet që e karakterizojnë atë quhet **Specifikimi i Dokumentit (DocSpec)**.

2. METODAT E KOMUNIKIMIT TE TE DHENAVE

Cdo IF duhet të transmetojë të dhënat e raporteve financiare të rezidentëve në juridiksionet e komunikuara, sipas juridiksionit, në një dosje të vetme ku të jete i ndare sipas juridiksioneve

DPT do të vë në dispozicion të IF, një program që synon kontrollin formal (kontrollin e klientit) dhe përgatitjen e file-t që do të transmetohet, duke lejuar kriptimin dhe nënshkrimin e tij me certifikatën e regjistruar në IF si përgjegjes i të dhënave të përfshira në të.

Dosja e transmetuar do t'i nënshtrohet një kontrolli të mëtejshëm në sistemet e pranimit të DPT-se, pas së cilës do të prodhohet një aprovim i skedarit ose refuzim i plotë i tij. Skedaret, kontrolli i të cilave prodhon një refuzim të tij do të konsiderohet se nuk është dërguar dhe për këtë arsye, nga IF do të kërkohet që ta ritransmetojë atë si duhet.

Dosja e pranuar do të përpunohet nga DPT në mënyrë që të veçojë të dhënat në baze të juridiksioneve që u komunikohen dhe t'i dërgojnë ato tek autoritetet kompetente përkatëse.

2.1 KONTROLLI FORMAL (KLIENT)

Kontrolli i klientit do të përfundojë:

- në verifikimin e vlefshmërisë së rrjedhës XML në lidhje me versionin e fundit të Skemës XSD të lëshuar nga OECD për shkëmbimin CRS;



- ne verifikimin e kufizimeve shtesë të parashikuara nga marrëveshjet CRS të përcaktuara në Shtojcën 3 të " *Common Reporting Standard User Guide* " të botimit "OECD (2017), *Standard for Automatic Exchange of Financial Account Information in Tax Matters, Second Edition*, OECD Publishing, Paris. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264267992-en>" të përjashtuar nga çdo përjashtim specifik për zonën kombëtare të mbledhjes së të dhënave;
- ne verifikimin e pranisë dhe korrektesisë formale të të gjithë kodeve tatimore shqiptare të pranishëm në mesazh;
- ne verifikimin e përputhshmërisë midis kodit tatimor shqiptar dhe llojit të personit (person fizik / person juridik);

Zbulimi i gabimeve (bllokuesit) ose paralajmërimeve (jo-bllokues) do të shfaqen në një skedar diagnostikues.

Prania e gabimeve në rrjedhë ndërpret procesin e përpunimit. Prandaj do të jetë e nevojshme të hiqni anomalitë dhe të përsërisni procedurën e kontrollit.

2.2 KONTROLI NE FAZEN E MIREPRITUR

Kur pranoni skedarin, do të bëhen dhe kontrollet e mëposhtme shtesë:

- Verifikimin e korrektesise dhe ekzistences ne regjistrin e taksave te TIN te IF te derguar te cilat jane te pranishme ne Mesazh i referohet elementit *SendingCompanyIN* e cila verifikon korrespondencen e saj me kodin fiskale te permbajtjes nenshkruese dhe derguese
- verifikimin e përputhshmërisë së fluksit të fituar në lidhje me versionin e fundit të softwarit të kontrollit të publikuar në faqen e internetit të A.T
- verifikimin e pajtueshmërisë me rregullat e dërgimit në lidhje me afatet;
- verifikimin e veçantisë së identifikuesve të raportuar së MessageRefID, DocRefId dhe ekzistencën e identifikuesve të raportuar ndoshta në fushat CorrMessageRefId dhe CorrDocRefId.

3. REGULLAT E KOMUNIKIMIT

Ky kapitull përshkruan se si të përpiloni skedarët që IF duhet t'i dërgojë A.T.

1.1 SKEMA E REFERENCES

Skema e referencës për specifikimet teknike është CrsXML v1.0 e publikuar ne [PORTAL I DEDIKUAR](#) i cili eshte i perbere nga file-t xsd si me poshte:

- CrsXML_v1.0.xsd
- CommonTypesFatcaCrs_v1.1.xsd



- FatcaTypes_v1.1.xsd
- OECDtypes_v4.1.xsd
- isocrstypes_v1.0.xsd


Skedari XML duhet të jetë formalisht i vlefshëm në lidhje me skemën CrsXML.

Shenim: mbani në mend se rregullat formale të përcaktuara nga Skema XSD nuk janë te plote për të prodhuar një skedar të saktë.


1.2 STRUKTURA E PERGJITHSHME E KOMUNIKIMIT **CRS**

Skema CrsXML përshkruan formatin dhe strukturën e komunikimit të të dhënave (Mesazhi CRS).


Messaggio CRS konsiston ne 2 bllok informacioni, **MessageSpec** dhe **CrsBody**.



